

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI EKONOMIK



**QEVERISJA KORPORATIVE DHE
AUDITIMI I BRENDSHËM NË
FUNKSION TË PERFORMANCËS SË
SEKTORIT BANKAR NË KOSOVË**

PUNIM I DOKTORATËS

Mentori:

Prof.Asoc.Dr. Arben Dërmaku

Kandidati:

Ass.MSc. Arbër Hoti

Prishtinë, 2018

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI EKONOMIK



MSc. Arbër Hoti

**QEVERISJA KORPORATIVE DHE
AUDITIMI I BRENDSHËM NË
FUNKSION TË PERFORMANCËS SË
SEKTORIT BANKAR NË KOSOVË**

PUNIM I DOKTORATËS

Prishtinë, 2018

UNIVERSITY OF PRISTINA
"HASAN PRISHTINA"
ECONOMIC FACULTY



MSc. Arbër Hoti

**CORPORATE GOVERNANCE AND
INTERNAL AUDIT AS A FUNCTION OF
BANK PERFORMANCE IN KOSOVO**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2018

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI EKONOMIK



MSc. Arbër Hoti

**QEVERISJA KORPORATIVE DHE
AUDITIMI I BRENDSHËM NË
FUNKSION TË PERFORMANCËS SË
SEKTORIT BANKAR NË KOSOVË**

PUNIM I DOKTORATËS

Mentori:

Prof.Ass.Dr. Arben Dërmaku

ABSTRAKT

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi të doktoratës është të studioj ndikimin e qeverisjes korporative dhe auditimit të brendshëm në performancën financiare të sektorit bankarë në Kosovë. Për të analizuar këtë ndikim, ndër tjerash, është aplikuar koeficienti i korrelacionit Pearson, testi-t i studentit dhe analiza e regresionit të shumëfishtë në lidhje me variablat e qeverisjes korporative, auditimit të brendshëm dhe performancës së sektorit bankar në Kosovë. Variablat kyçe të qeverisjes korporative që janë studiuar në këtë hulumtim janë: (i) madhësia e bordit të drejtorëve, (ii) pavarësia e bordit të drejtorëve (raporti ndërmjet drejtorëve jo-ekzekutiv dhe numrit total të anëtarëve të bordit), (iii) përbërja e bordit të drejtorëve (raporti ndërmjet drejtorëve të huaj ndaj numrit total të anëtarëve të bordit), (iv) diversiteti gjinor i bordit të drejtorëve, (v) pronësia e drejtorëve të bordit në bankë. Ndërkaq, variablat kyçe të auditimit të brendshëm që janë studiuar në këtë hulumtim janë: (vi) madhësia e ekipit të auditimit të brendshëm, (vii) kualifikimi profesional i ekipit të auditimit të brendshëm (viii) pavarësia organizative e departamentit të auditimit të brendshëm (DAB), dhe (ix) raporti ndërmjet rekomandimeve të implementuara në raport me ato të dhëna nga auditimi i brendshëm.

Burimi i të dhënave të këtij hulumtimi janë të dhënat që janë grumbulluar nga raportet vjetore dhe pasqyrat financiare të audituara të bankave komerciale në Kosovë për periudhën 12 vjeçare (2006-2017), nga pyetësorët drejtuar auditorëve të brendshëm dhe anëtarëve të bordit të bankave komerciale në Kosovë si dhe nga publikimet e tjera nga institucionet relevante vendore si Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Enti i Statistikave të Kosovës (ESK), Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), etj.

Rezultatet e analizës së regresionit të shumëfishtë në lidhje me *ndikimin e bordit të drejtorëve* në performancën financiare të sektorit bankarë tregojnë që: madhësia e bordit të drejtorëve, pavarësia e bordit të drejtorëve, prezenca e anëtarëve të bordit me nacionalitet të huaj si dhe pronësia e anëtarëve të bordit në bankë, kanë ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm (signifikant) në performancën financiare të sektorit bankarë në Kosovë, të shprehur nëpërmjet treguesve të kthimit mbi pasuri (ROA) dhe kthimit mbi ekuitet (ROE). Poashtu, rezultatet e testit-t, tregojnë që në sektorin bankar në Kosovë nuk është vërejtur ndonjë dallim apo diferencë signifikante në performancë nga aspekti statistikor, ndërmjet periudhës para krizës financiare 2006-2007 dhe periudhës gjatë krizës financiare 2008-2009, andaj është konstatuar që qeverisja korporative e bankave në Kosovë ka treguar rezultat pozitiv në menaxhimin e performancës financiare gjatë kësaj periudhe.

Rezultatet e analizës së regresionit të shumëfishtë në lidhje me *ndikimin e auditimit të brendshëm* në performancën financiare të sektorit bankarë tregojnë që: madhësia e ekipit të auditimit të brendshëm, kualifikimi profesional i auditorëve të brendshëm dhe përqindja (niveli) e implementimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm, kanë ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm (signifikant) në performancën financiare të sektorit bankarë në Kosovë, të shprehur nëpërmjet treguesve të kthimit mbi pasuri (ROA) dhe kthimit mbi ekuitet (ROE).

Gjetjet e këtij hulumtimi janë në harmoni me gjetjet e hulumtuesve të tjerë të kësaj fushe, si dhe konfirmojnë pohimin që menaxhimi i variablave të lartpërmendura përmirëson dhe ka ndikim pozitiv në performancën financiare të bankave në Kosovë.

Fjalët kyçe: performanca financiare, bordi i drejtorëve, auditimi i brendshëm, sektori bankar;

ABSTRACT

The main purpose of this PhD research is to study the impact of corporate governance and internal audit on the financial performance of the banking sector in Kosovo. To analyze this impact, the Pearson correlation coefficient, student t-test, and multiple regression analysis related to the variables of corporate governance, internal audit and banking sector performance in Kosovo were applied. The key corporate governance variables that have been studied in this research are: (i) size of the board of directors, (ii) the independence of the board of directors (the ratio between non-executive directors and the total number of board members), (iii) composition of the board of directors (ratio between foreign directors to total number of board members), (iv) the gender diversity of the board of directors, (v) the ownership of the board's directors in the bank. Meanwhile, the key internal audit variables that have been studied in this research are: (vi) the size of the internal audit team, (vii) professional qualification of the internal audit team (viii) the organizational independence of the internal audit department (IAD), and (ix) the ratio between implemented recommendations in relation to those provided by the internal audit.

The data for this research were collected from the annual reports and audited financial statements of commercial banks in Kosovo for the 12 year period (2006-2017), from questionnaires addressed to internal auditors and board members of commercial banks in Kosovo as well as other publications from relevant local institutions such as the Central Bank of Kosovo (CBK), Statistical Office of Kosovo (SOK), Tax Administration of Kosovo (TAK), etc.

The results of the multiple regression analysis regarding the influence of the board of directors on the financial performance of the banking sector indicate that: the size of the board of directors, the independence of the board of directors, the presence of board members of a foreign nationality and the ownership of the members of the board in the bank have a positive and significant impact on the financial performance of the banking sector in Kosovo, expressed through return on assets ROAs and return on equity (ROE). Also, the t-test results show that no significant differences its noted in performance from the statistical point of view between the pre-financial crisis period 2006-2007 and the period during the financial crisis 2008-2009 therefore, it has been ascertained that the corporate governance of banks in Kosovo has shown a positive result in financial performance management during this period.

The results of the multiple regression analysis regarding the impact of internal audit

on the financial performance of the banking sector indicate that: the size of the internal audit team, the professional qualification of internal auditors and the percentage (level) of the implementation of recommendations given by internal audit, have a positive and significant impact on the financial performance of the banking sector in Kosovo, expressed through Return on Assets (ROA) and Return on Equity (ROE).

Findings of this research are in line with the findings of other researchers in this field and confirm the assertion that the management of the above variables improves and has a positive impact on the financial performance of banks in Kosovo.

Key words: financial performance, board of directors, internal audit, banking sector;